

FORUMI I DYTË RAJONAL I SIGURIMIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT

# Shembuj Praktik të Mbikëqyrjes Publike dhe Kontrollit të Cilësisë së Auditimit

7-8 nëntor, 2023, Shkup, Maqedonia e Veriut



Qendra për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR),  
Praktika Globale e Qeverisjes,  
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, Banka Botërore  
Adresa: Praterstrasse 31, 1020 Vjenë, Austri  
Web: [www.worldbank.org/cfrr](http://www.worldbank.org/cfrr)  
Email: [cfrr@worldbank.org](mailto:cfrr@worldbank.org)  
Tel: +43-1-217-0700

# Shembuj Praktik të Mbikëqyrjes Publike dhe Kontrollit të Cilësisë së Auditimit

7-8 nëntor, 2023, Shkup Marriott Hotel, Shkup, Maqedonia e Veriut

## PARATHËNIE

**Programi Rruga drejt Evropës për Reformën e Kontabilitetit dhe Forcimin Institucional për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (REPARIS për NVM-të)** synon të mbështesë: (i) përmirësimin e mëtejshëm të qasjes së NVM-ve të Ballkanit Perëndimor në shërbimet profesionale të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar, dhe (ii) harmonizimin e kuadrit të raportimit financiar të korporatave të vendeve të Ballkanit Perëndimor me direktivat dhe rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian (BE). Përfituesit e projektit janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

REPARIS për NVM-të bazohet në progresin e bërë në kuadër të Programit të përfunduar BE-REPARIS (2015-2019). Ai realizohet nga **Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR)** me seli në Vjenë, Austri në bashkëpunim të ngushtë me Zyrat e Bankës Botërore në vendet përfituese. Aktivitetet e projektit përfshijnë trajnime, ngjarje mësimore, ndihmë teknike të ofruar për zyrtarët publik, rregullatorët, kontabilistët, auditorët, organizatat profesionale të kontabilitetit, organizatat për mbështetje të biznesit dhe dhomat e tregtisë. Komponentët kryesorë të projektit janë:

- (A) Mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e programeve të edukimit dhe trajnimit të qëndrueshëm.
- (B) Mbështetje për transpozimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor kombëtar dhe praktikave në raportimin financiar dhe auditimin me kërkesat e BE-së.
- (C) Mbështetje të një qasjeje rajonale për zbatimin e reformave të përfunduara të kontabilitetit dhe auditimit.
- (D) Vlerësime të peizazhit të shërbimeve këshillimore të kontabilitetit dhe Raporteve të Kontabilitetit dhe Auditimit mbi Respektimin e Standardeve dhe Kodeve.

Takimi inaugurues i Forumit Rajonal të Sigurimit të Cilësisë së Auditimit u mbajt në Vjenë më date 16-17 maj të vitit 2023 dhe mbledhi përfaqësuesit e autoriteteve kompetente përgjegjëse për mbikëqyrjen publike dhe sigurimin e cilësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Forumi i dytë i Sigurimit të Cilësisë së Auditimit synon të ofrojë trajnime të përshtatura për anëtarë të bordit, stafin kryesor ekzekutiv të autoriteteve kompetente dhe inspektorët e

cilësisë së auditimit mbi qeverisjen, parimet dhe zbatimin praktik të mbikëqyrjes publike dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë. Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells (ICAEW) është punësuar për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve nën komponentët B dhe C të REPARIS për NVM-të dhe do të sigurojë sesione trajnimi dhe materiale mësimore.

Për më tepër, pjesëmarrësit do të mësojnë për rolin dhe përgjegjësitë e komisioneve të auditimit në lidhje me raportimin financiar dhe të qëndrueshmërisë në përputhje me dispozitat e BE-së. Kjo do t'i ndihmojë ata të kuptojnë më mirë punën e komisioneve të auditimit dhe të zhvillojnë një metodologji të përshtatshme vlerësimi.

Gjuha e ngjarjes do të jetë gjuha angleze me përkthim simultan në gjuhën shqipe dhe boshnjake/kroate/serbe.

# AGJENDA | DITA 1 | E MARTË, 7 NËNTOR, 2023

08:30 Regjistrimi dhe kafe për mirëseardhje

09:00 Komete përshëndetëse

Iwona Warzecha | Specialiste e Lartë e Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

09:10 Sesion për "thyerjen e akullit"

Gjatë këtij sesioni, secili pjesëmarrës do të ftohet të prezantojë veten dhe të deklarojë rolin e tij në sistemet e mbikëqyrjes publike dhe/ose të sigurimit të cilësisë.

Moderator: Jon Hooper | Menaxher i Lartë, Ngritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

09:30 Sesioni i trajnimit 1: Legjislacioni dhe Rregulloret për Mbikëqyrjen Publike dhe Sistemet e Sigurimit të Cilësisë

Ky sesion do të shqyrtojë shembuj të vërtetë mbi legjislacionin e mbikëqyrjes publike dhe të sigurimit të cilësisë dhe se si Bordet e Mbikëqyrjes Publike (POB) fitojnë dhe përdorin autoritetin, fuqinë, sanksionet dhe kompetencat për sigurimin efektiv të cilësisë për auditim.

Jon Hooper | Menaxher i Lartë, Ngritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

Moderator:

Iwona Warzecha | Specialiste e Lartë e Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

10:30 Pushim për kafe

11:00 Sesioni i trajnimit 2: Qeverisja dhe Parimet e Mbikëqyrjes Publike dhe Sistemet e Sigurimit të Cilësisë

Ky sesion mbulon praktikat më të mira të përbashkëta dhe marrëveshjet e qeverisjes homologe që lehtësojnë mbikëqyrjen efektive dhe sigurimin e cilësisë. Kjo përfshin strukturën dhe përgjegjësitë e komisionit, pavarësinë, raportimin dhe zbatimin e sanksioneve. Pjesëmarrësit do të ftohen të ndajnë arranzhimet (rregullimin) e tyre aktuale dhe të diskutojnë pikat e forta dhe të dobëta të tyre.

Jon Hooper | Menaxher i Lartë, Ngritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

**Katerina Rafalska** | Eksperte e Lartë, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

Moderator:

**Svetlana Platon** | Konsulente e Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

---

**12:30** Drekë

---

**13:30** **Sesioni i trajnimit 3: Alternativat për Metodologjinë e Inspektimit të Auditimit**

---

Ky sesion do të demonstrojë një sërë filozofish, qasjesh dhe metodologjish inspektimi dhe zgjedhjet që mund të bëjnë Bordet e Mbikëqyrjes Publike (POB-të) dhe inspektorët. Folësit do të nënvizojnë pikat e forta dhe sfidat e secilit sistem, me delegatë që do të marrin pjesë të cilët do të zgjidhnin dhe si mund t'i përshtatnin qasjet.

**Sally Davies** | Inspektore e Sigurimit të Cilësisë, Departamenti i Sigurimit të Cilësisë, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

**Katerina Rafalska** | Eksperte e Lartë, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

Moderator:

**Jon Hooper** | Menaxher i Lartë, Ngritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

---

**15:00** Pushim për kafe

---

**15:30** **Sesioni i trajnimit 4: Rast-Studim praktik 1. "Shmangia e katastrofës në takimin përmbyllës me auditorin"**

---

Pjesëmarrje e grupit në një studim rasti pjesëmarrës që eksploron sfidat e paraqitjes dhe diskutimit të dobësive dhe gjetjeve të rëndësishme auditorit ose firmës së auditimit.

**Jon Hooper** | Menaxher i Lartë, Ngritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

**Katerina Rafalska** | S Eksperte e Lartë, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

Moderator:

**Andrei Busuioc** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

---

**17:00** Fundi i ditës së 1-rë

---

18:00 Darkë të përbashkët në restorantin Stara Kuqa

---

21:00 Fundi i darkës së përbashkët

---

## AGJENDA | DITA 2 | E MËRKURË, 8 NËNTOR, 2023

09:00 Sesioni i trajnimit 5: Shembuj nga jeta reale të rezultateve të inspektimit

---

Ky sesion shqyrton studime të thelluara faktike të rasteve të shembujve të fundit të rezultateve të publikuara të inspektimeve të cilësisë, nga gjobat në miliona dollarë deri te heqja e praktikuesve të vegjël dhe të mesëm dhe licencat e praktikuesve individ.

**Sally Davies** | Inspektore e Sigurimit të Cilësisë, Departamenti i Sigurimit të Cilësisë, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

**Katerina Rafalska** | Eksperte e Lartë, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

Moderator:

**Jon Hooper** | Menaxheri i Lartë, Ngritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

---

10:30 Pushim për kafe

---

11:00 Sesioni i trajnimit 6: Studim praktik rasti 2. Lojë me role “Probleme në Komisionin e Regjistrimit të Auditimit”

---

Pjesëmarrje në grup në një studim rasti që eksploron sfidat e shqyrtimit efektiv të raporteve të inspektimit që theksojnë auditimin me cilësi të dobët, duke marrë parasysh opsionet dhe veprimet në dispozicion të komisionit ose bordit të regjistrimit.

**Jon Hooper** | Menaxheri i Lartë, Ngritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

**Katerina Rafalska** | Eksperte e Lartë, Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar në Angli dhe Uells

Moderator:

**Andrei Busuioc** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

---

12:30 Drekë

---

13:30

## **Përmirësimi i cilësisë së auditimit në vendet e Ballkanit Perëndimor përmes bashkëpunimit rajonal**

---

Ky sesion paraqet një mundësi për pjesëmarrësit që të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të pranojnë komente kthyesë të menjëhershme. Atyre do t'u kërkohej të theksojnë pritshmëritë e tyre në lidhje me përmbajtjen, formatin dhe audiencën për trajnime të mëtejshme në fushën e sigurimit të cilësisë. Për më tepër, pjesëmarrësit do të bien dakord për temat që do të diskutohen si pjesë e ngjarjes së ardhshme rajonale.

Moderatorë:

**Svetlana Platon** | Konsulente e Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

**Jon Hooper** | Menaxher i Lartë, Ngritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare, ICAEW

---

14:45

## **Pushim për kafe**

---

15:15

## **Vlerësimi i Performancës së Komisioneve të Auditimit**

---

Në përputhje me Rregulloren e BE-së Nr. 537/2014, autoriteteve kompetente u kërkohej të monitorojnë rregullisht tregun për ofrimin e shërbimeve të auditimit ligjor për subjektet me interes publik dhe të vlerësojnë performancën e komisioneve të auditimit. Objektivi i këtij sesioni është të ndihmojë përfaqësuesit e organeve të mbikëqyrjes publike të kuptojnë më mirë punën e komisioneve të auditimit dhe të zhvillojnë një metodologji të përshtatshme vlerësimi.

Gjatë sesionit, do të paraqitet roli dhe përgjegjësitë e komisioneve të auditimit në lidhje me raportimin financiar dhe të qëndrueshmërisë në përputhje me dispozitat e BE-së. Gjithashtu, auditorit do t'i ofrohen shembuj të praktikave të mira bazuar në aktivitetet e komisioneve të auditimit në Poloni, duke theksuar çështjet përkatëse për sektorin bankar dhe kompanitë e mëdha të listuara. Prezantimi do të pasohet nga një sesion pyetjesh dhe përgjigjesh.

**Vladimir Hrlje** | Konsulent, Korporata Financiare Ndërkombëtare, Grupi i Bankës Botërore

**Danuta Dąbrowska** | Anëtare e pavarur e Bordeve Mbikëqyrëse, Partnere Themeluese në Oryx Group

Moderator:

**Andrei Busuioc** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

---

16:30

## **Komente përmbyllëse**

---

**Andrei Busuioc** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

---

17:00

## **Fundi i ngjarjes**

---



